

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbime vijëzimi, vendosje sinjalistike”

Fondi limit i Marrëveshjes Kuadër për 29 muaj në total është: 20 108 828.40 (njëzet milion e njëqind e tetë mijë e tetëqind e njëzot e tetë pkië dyzet) **Lekë Pa Tvsh, ose 202,546.61 euro.**

Fondi limit për 2024 është: 5,717,044.64 (pesë milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e dyzet e katër pikë gjashtëdhjetë e katër) **Lekë pa tvsh, ose 57,585.05 Euro**

Fondi limit për 2025 është: 7,489,899.78 (shtatë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e tetë) **Lekë pa tvsh, ose 75,442.18 Euro**

Fondi limit për vitin 2026 është: 6,901,883.98 (gjatë milion e nëntëqind e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre pikë nëntëdhjetë e tetë) **Lekë pa tvsh, ose 69,518.87 Euro**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Vijëzime të rrugëve 34922100-7, Sinjalistikë Rrugore 34992200 - 9

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Tirana Parking**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Shërbime të një natyre të ngjashme për një ose disa objekt në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë me vërtetime të lëshuara nga ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë vetëm me fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që të garantojnë autoritetin, se operatori ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2. Operatorët ekonomike duhet të paraqesin liçencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ose institucionet e autorizuar me ligj sipas formatit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Proçedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i liçencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- NS – 6/A (Sinjalistika rrugore jondricuese)

| Kategoria e kërkuar | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive |
|---------------------|--|--|---|
| NS – 6/A | Sinjalistika rrugore jo ndricuese | Vendosje sinjalesh jo ndricues, vendosje tabelash, shenjime rrugësh. | 0-100 |

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij

kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë licencat profesionale të domosdoshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 10 (dhjetë) punonjes. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhen 3 (tre) muajt e fundit.

Për të dëshmuar fuqinë punëtore operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhen 3 (tre) muajt e fundit
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9.Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 10 persona është në përputhje me volumin e shërbimit, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM

per kohen e punes ne muaj per punonjes. Po t'i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Eshte vendosur qe numri i punonjesve ne dispozicion te operatorit ekonomik per realizimin e kontrates te jete minimalisht 10 punonjes per 3(tre) muajt e fundit pasi kjo kërkesë lidhet me domodoshmërinë për realizimin e objektit te prokurimit, eshte në një numër të justifikuar që i shërben vetem objektit konkret.

4.Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme
- b) Diplomë
- c) CV përkatëse

Si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet në objekt. Të siguruar sipas legjislacionit në fuqi gjitha shërbimet në këtë objekt.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9.Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4, gërma ”b”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit qe do te realizohen dhe do te monitorohen ne vazhdimesi nga ky drejtues teknik.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** për punimet përkatëse në liçensën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Inxhinier ndërtimi 1 (një)

2. Inxhinier Gjeodet/Topograf 1 (një)

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4, gërma ”b”) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Inxhinier ndërtimi dhe inxhinier Gjeodet/Topograf, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga këta inxhinierë.

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

1 (një) punonjës i çertifikuar për “Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 ”Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë diplomë / Çertifikatat e cituara më sipër.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

7.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

| Nr | Emri i mjetit | Njesi | Sasi | Statusi |
|----|---|-------|------|------------------------|
| 1 | Kamion me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton | Copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 2 | Makineri vijezimi airless | Copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 3 | Matrapik, freze me gotë | Cope | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 4 | Mjet për pastrimin e vijave/ bojës egzistuese | Copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 5 | Set semaforësh (çift) për kontrollin e trafikut | Copë | 1 | Në pronësi ose me qera |

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot përkatëse;
Ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
 - Mjet transporti kaminon me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton, kërkohet për transportimin e makinerive të nevojshme për kryerjen e punimeve mbi asfalt.
 - Matrapik, frezë me gotë kërkohet për të hapur në asfalt vrimat e vendosjes së tabelave, me qëllim demtimin sa më pak të shtresave të asfaltit.
 - Makineri vijezimi airless kërkohet për aplikimin e bojës në performancë të lartë.
 - Makineri fshirje (për vjézimet e dëmtuara), kërkohet për fshirjen e bojës të dëmtuar ekzistente në asfalt me qëllim mos dëmtimin e asfaltit.
 - Set semaforësh (çift) për kontrollin e trafikut kërkohet për rregullimin e trafikut dhe ruajtjes së sigurisë së punonjësve.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma ”ç” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe paisjet teknike të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

7.Kandidati/ofertuesi duhet te paraqesi çertifikatën e vlefshme për standartin:

| | | |
|----------------|-----------------|--|
| ISO 9001:2015 | ose ekuivalente | Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë |
| ISO 14001:2015 | ose ekuivalente | Sistemet e Menaxhimit Mjedor |
| ISO 45001:2018 | ose ekuivalente | Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë |

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenet 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit dhe siguron qëndrueshmërinë e shërbimeve, si dhe vlen në vazhdimësi për realizimin e kërkesave të AK nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemeve përkatëse.

Vendosja e çertifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike, termave të references dhe në varësi të zërave përkatës të shërbimit objekt prokurimi. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të çertifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

a) Autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për materialet (Bojë akrelike e bardhe/e verdhe/blu, adeziv).

Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

Secili nga dokumentat e sipërcituar, duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si: tel., e-mail, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave, si dhe te jete origjinale ose fotokopje e noterizuar e njehsuar me origjinalin, dhe nëse eshte ne gjuhe te huaj, duhet te jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar, sipas konfirmimit te noterit.

b)Per materialet e kerkuara (**Bojë akrelike e bardhe/e verdhe/blu, adeziv**), te paraqiten katalog/et **ose** skedat teknike te prodhuesit/ve, ku te specifikohen materialet qe do te ofrohen, si dhe te paraqiten certifikate/deklarate konfirmiteti CE **ose** certifikatat e cilesise **ose** raportet e testimi nga laboratore te akredituar, me qellim permbushjen e standarteve te kerkuara ne specifikimet teknike per keto materiale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, Nr. prot 3341/1, datë 20.03.2018

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti Kontraktor duke qenë se është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkoje ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

9. Kandidati ofertues datën e hapjes së ofertës duhet të paraqesë pranë zyrave tona mostrat:

- Bojë akrelike e bardhë
- Bojë akrelike e verdhë
- Bojë akrelike blu
- Adeziv

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6, gërma "b" si dhe nenin 41, pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar.

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK. Ky kriter konsiderohet i nevojshëm dhe i rëndësishëm për vlerësimin e ofertës teknike të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.